VENDIM
Nr. 520, datë 13.6.2013

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS TRUALL, ME SIPËRFAQE 3500 M^2, ME VENDNDODHJE NË KOMUNËN FARKË, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT TE MINISTRIA E BRENDSHME, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës truall, me sipërfaqe 3500 (tri mijë e pesëqind) m^2, me vendndodhje në komunën Farkë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit te Ministria e Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për sistemimin e stacionit të policisë, Farkë, sipas formularit dhe genplanit bashkëlidhur këtij vendimi (pjesa e ngjyrosur).

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit, e miratuar me vendimin nr. 413, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, dhe t'i shtohet listës së inventarit të pronave, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar.

3. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: _ DREJTORIA E PERGJITHSHME E REZERVAVE SHTETERORE

Bashkia / Komuna: FARKE, RRETHI TIRANE

Fusha e perdorimit te Prones: _ REZERVE SHTETI

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar [illegible])

	A		B					C	
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m^2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni perdorues Statusi juridik i perdorimit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1			AGJENSIA LUNDER						
			KOMUNA Farke	TRUALL	Brenda territorit	105000	Vendosja e objektit	D.P.R.SH	D.R.Tirane
			Veri: Lagja "Daçi"	NDERTESE ZYRE, 2 kat	Brenda territorit	106.4	Per zyra	D.P.R.SH	D.R.Tirane
			Jug: Fusha e Monit	NDERTESE+MBULESE	Brenda territorit	6005	Per peshim	D.P.R.SH	D.R.Tirane
			Lindje:Lagja Xix	PESHOREJE					
			Per: Pronar Bim	PALLAT, banimi, 2 kat	Brenda territorit	293.3	Per banim	D.P.R.SH	D.R.Tirane
				DHOMA E ROJEVE	Brenda territorit	7.8	Per roje	D.P.R.SH	D.R.Tirane
				KABINA ELEKTRIKE	Brenda territorit	28	Per ndriçim	D.P.R.SH	D.R.Tirane
				DHOME PER PUNETORE	Brenda territorit	48.4	Per pushim te	D.P.R.SH	D.R.Tirane
				1kat me çati tjegulle			punetoreve		
				MAGAZ. PERDORIMIT	Brenda territorit	344.52	Mallra dhe material	D.P.R.SH	D.R.Tirane
				1 kat me çati eterniti			ne perdorim		
				KAPAN.,1kat ç.eterniti	Brenda territorit	290.7	Per makina	D.P.R.SH	D.R.Tirane



I FRAGMENT
PLAN-VENDOSJA
SHK. 1:1000
DREJTORIA PERGJITHSHME E REZERVAVE
MATERIALE TE SHTETIT

OBJEKTI "KAPANONI NR. 22"

TRUALLI ME SIPERFAQE ≈ 3500M²
QE KERKOHET PER KALIM NE PERGJEGJESI
ADMINISTRIMI NGA D.P.R.M.SH. TEK D.P.P.SH